

INDUSTRIA
NXJERRËSE NË
SHQIPËRI



ALBEITI RAPORTI I PROGRESIT VJETOR 2024

Tiranë 2025



RAPORTI VJETOR I PROGRESIT (APR) I ALBEITI – 2024

I. HYRJE

Raporti Vjetor i Progresit për vitin 2024 i Sekretariatit Kombëtar të EITI Shqipëri (ALBEITI) përfaqëson një pasqyrë të gjithanshme të angazhimit institucional dhe teknik të ndërmarrë gjatë vitit për të garantuar një zbatim substancial dhe të qëndrueshëm të Standardit Ndërkombëtar EITI. Ky dokument përmban një analizë të thelluar të progresit të arritur në përmbushjen e objektivave strategjike të përcaktuar në Planin Kombëtar të Punës 2024–2025, i cili është miratuar unanimisht nga Grupi Shumëpalësh i Interesit (MSG).

Raporti evidenton qasjen metodologjike dhe institucionale të ndjekur nga ALBEITI në avancimin e transparencës dhe përgjegjshmërisë në sektorët e industrisë nxjerrëse dhe energjisë, në përputhje me kërkesat më të fundit të Standardit EITI 2023.

Ai përfshin rezultate të prekshme në disa fusha kyçe, përfshirë përgatitjen dhe publikimin e raporteve shumëvjeçare EITI, forcimin e sistemit të raportimit dhe analizës së të dhënave sektoriale, nxitjen e pjesëmarrjes së aktorëve joqeveritarë dhe institucionalë, dhe zhvillimin e mjeteve të reja për transparencën fiskale dhe kontraktuale.

Një tjetër aspekt qendror i raportit është përqendrimi në përmirësimin e kuadrit institucional dhe ligjor që mbështet zbatimin e kërkesave të EITI. Gjatë vitit 2024, Sekretariati ka ndërmarrë iniciativë të rëndësishme në drejtim të përforcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional për ceshtje që lidhen me pronësinë përfituese dhe transparencën kontraktuale, si dhe ka garantuar ruajtjen e standardeve të qeverisjes së mirë në raport me detyrimet ndërkombëtare që Shqipëria ka si vend anëtar i EITI-t.

Ky raport mbështetet në një analizë gjithëpërfshirëse të dokumentacionit teknik dhe operacional të përgatitur nga Sekretariati gjatë vitit, përmbledhjen sistematike të aktiviteteve të realizuara në terren, të dhënat nga raportimi EITI dhe të dhëna të tjera shtetërore, si dhe në konsultimet e zhvilluara me palët e interesuara brenda dhe jashtë MSG-së. Ai përfaqëson një instrument zyrtar monitorimi dhe vlerësimi, që jo vetëm dokumenton ecurinë e punës për vitin referues, por edhe shërben si bazë për përmirësim të vazhdueshëm institucional dhe përafrim me praktikatat më të mira ndërkombëtare në fushën e transparencës dhe qeverisjes së burimeve natyrore.

Përmbledhje e punës së AlbEITI gjatë vitit 2024

Gjatë vitit 2024, Sekretariati Kombëtar i AlbEITI arriti të rikthejë procesin e raportimit në rrjedhën e tij të zakonshme dhe të forcojë transparencën në sektorët nxjerrës, duke adresuar mangësitë e mbetura nga procesi i Validimit dhe duke e përafruar punën me Standardin EITI 2023. Arritjet kryesore përfshijnë:

Raportimi dhe transparencja

- Finalizimi dhe publikimi i **Raportit të konsoliduar për vitet 2019–2021**, një nga arritjet më të rëndësishme të vitit.
- Nisja e procedurave për përgatitjen e **raporteve të viteve 2022 dhe 2023**, përfshirë hartimin e Termave të Referencës dhe ngritjen e grupit teknik për mbledhjen dhe verifikimin e të dhënave.

Teknologjia dhe të dhënat e hapura

- Mirëmbajtja dhe përditësimi i **Portalit të të Dhënave të Hapura (open.albeiti.org)** dhe **Kadastrës Minerare**, me:
 - migrim në serverë të sigurt dhe backup automatik,
 - ndërfaqe të re UI/UX,
 - publikim dinamik të pagesave, grafikë interaktivë dhe API të hapura,
 - seksione të posaçme për raportet, strategjitë dhe planet e punës.

Zgjerimi i fushës së raportimit

- Nisja e punës për raportimin e **Pronësisë Përfituese (Beneficial Ownership)**, përmes analizës së kuadrit ligjor, konsultimeve me QKB dhe përgatitjes së Termave të Referencës për një studim të dedikuar.

Komunikimi dhe ndërgjegjësimi publik

- Realizimi i një **spoti sensibilizues** dhe i një **dokumentari mbi veprimtarinë e EITI**, të shpërndarë në faqen zyrtare dhe rrjetet sociale.
- Publikimi i njoftimeve dhe materialeve informuese mbi rolin e MSG-së dhe strukturën e AlbEITI-t.
- Më **7 tetor 2024**, u shpall **heqja e pezullimit të Shqipërisë nga EITI**, një moment historik që forcoi besueshmërinë e procesit.

Trajnimi dhe kapacitetet institucionale

- Trajnime për institucionet publike dhe operatorët mbi transparencën fiskale dhe përdorimin e të dhënave.
- Pjesëmarrja e stafit në programe ndërkombëtare të OECD, GIZ dhe Qendrës së Trajnimit për Energjinë.
- Hartimi dhe publikimi për herë të parë i **Planit të Integritetit Institucional 2024–2025**.

Angazhimi ndërkombëtar

- **Vizita e Sekretariatit Ndërkombëtar të EITI** në Shqipëri (qershor 2024) për diskutimin e zbatimit të Standardit 2023.
- **Pjesëmarrja në Takimin Global të Koordinatorëve Kombëtarë të EITI në Gjenevë**.
- **Takime me Misionin e Bankës Botërore** në Shqipëri për monitorimin e progresit dhe sigurimin e mbështetjes së mëtejshme financiare dhe teknike.

Nisja e punës për ToR dhe studime të reja strategjike

Në kuadër të zgjerimit të transparencës dhe raportimit, gjatë 2024 u hartuan terma reference për konsulencë të reja mbi:

1. **Vlerësimin e ndikimit të Ligjit të Pronësisë Përfituese.**
2. **Tranzicionin e Energjisë** dhe përgatitjen e modelit të raportimit për sektorin e rinovueshëm dhe gazin natyror.
3. **Analizën gjinore** dhe përfshirjen e dimensionit gjinor në raportimin EITI.
4. **Ndikimet socio-ekonomike të industrisë së naftës** dhe rreziqet e tranzicionit energjetik.
5. **Shëndetin dhe Sigurinë në Punë** në industrinë nxjerrëse (2024).
6. **Ndikimin e investimeve të huaja** në sektorin nxjerrës.

Programi i Qeverisë Shqiptare 2021-2025 i lidhur me Aktivitetet e Planit të Punës

Ndërkohë që arrihet përputhshmëria me Standardin Global EITI, është shumë e rëndësishme në të njëjtën kohë të jetë në përputhje me objektivat kryesore të Programit të Qeverisë Shqiptare 2021-2025 dhe Veprimet korrektuese që do të zbatohen. Programi zyrtar i Qeverisë Shqiptare 2021-2025 është konceptuar si një plan i kujdesshëm dhe program i detajuar reformash dhe veprimesh, që synon të materializohet në çdo qelizë të Vizionit "Shqipëria 2030" të qeverisjes, një projekt madhor që mishëron ambicien për ta çuar Shqipërinë në nivelin e ardhshëm të zhvillimit ekonomik dhe social. Objektivat e qarta të përcaktuara në Programin e Qeverisë Shqiptare për të ndërtuar hap pas hapi të ardhmen evropiane të Shqipërisë, duke u mbështetur në thelb në shtyllat kryesore, ndërsa 3 kryesore të formuluar në Program janë:

1. Rimëkëmbja ekonomike nga situata e pandemisë së tërmeteve dhe kriza energjetike;
2. Mirëqenie për të gjithë, e cila do të përkthehet në një ekonomi të zhvilluar që krijon mundësi për të gjithë.
3. Modernizimi për zhvillimin e Ekonomisë prodhuese, Turizmit, Energjisë etj.

Në Programin e Qeverisë Shqiptare 2021-2025 është formuluar se “Bazuar në objektivin për një ekonomi të fortë dhe të qëndrueshme nëpërmjet modernizimit, produktivitetit dhe konkurrueshmërisë, Shqipëria do të jetë një eksportues neto i Energjisë Elektrike në të gjithë Rajonin; me një sistem Energjetik shumë më të larmishëm dhe një vend që reduktimi i rezervave të tij të energjisë hidroenergjetike të rinovueshme gjatë thatësirës do ta kompensojë atë me energjinë e gjelbër, të prodhuar nga impiantet diellore dhe të erës”.

Në Programin e Qeverisë Shqiptare 2021-2025 në Kapitullin e Integritimit Europian është formuluar: “Në vitin 2014, Shqipëria mori statusin e vendit kandidat, pas përmbushjes në 5 fusha kryesore kyçe, ku përfshihej lufta kundër korrupsionit. Shqipëria ka bërë progres të qëndrueshëm në të gjitha prioritetet e përcaktuara nga BE dhe si rezultat i këtyre arritjeve në mars 2020 BE mori vendimin për hapjen e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë, hapi i fundit drejt integritimit të plotë”. Albeiti MSG dhe Sekretariati Kombëtar janë plotësisht

të përkushtuar për të siguruar që zbatimi EITI të vazhdojë të jetë relevant dhe në përputhje të duhur me prioritetet kombëtare.

Formulimi i komponentëve të Planit të Punës EITI ka marrë parasysh që aktivitetet duhet të jenë të përputhshme dhe organike në harmoni me objektivat dhe platformat kryesore të përcaktuara në Programin Drejtues për Industrinë Nxjerrëse në Sektorin e Energjisë. Aktivitetet mbështetëse të zbatimit të EITI të përfshira në planin e punës do të mbështesin objektivat thelbësorë për zbatimin e EITI dhe për të përmbushur dhe ruajtur detyrimet e statusit të tij në përputhje me EITI, duke përfshirë Raportin Vjetor EITI për Shqipërinë.

Përgatitja e raportit vjetor EITI që mbulon të gjitha industritë nxjerrëse për vitin kalendarik 2019 dhe 2020-2021. Hartimi i këtij raporti vjetor është një kërkesë themelore e Standardit EITI. Ky Aktivitet (A) i përfshirë në Planin e Punës optimizon Programin e QSH-së 2021-2025 në objektivat si më poshtë: “Një parim kaq i rëndësishëm i përfshirjes së publikut në proceset vendimmarrëse do të jetë boshti i qeverisë, në një formë më të strukturuar, ku partneriteti me çdo qytetar shqiptar do të jetë partner i qeverisë, si garanci e Transparencës por edhe e matjes së rregullt të performancës së qeverisë”. Gjithashtu Aktivitetet A (Raporti Vjetor EITI për Shqipërinë) të Planit të Punës përfshijnë zbulimin e të dhënave për Sektorin e Energjisë dhe do të pasqyrojnë objektivat e Programit të Qeverisë Shqiptare 2021-2025.

Gjatë 2024, pavarësisht se ndërtimi fizik nuk ka nisur ende, është arritur progres domethënës në sektorin përgatitor dhe përfitime strategjike që shtojnë vlefshmërinë e projektit Skavicës. Deri në fund të vitit 2023, ishin finalizuar studimet kryesore: fizibiliteti, studimi hidrologjik, gjeologjik, vlerësimi social dhe mjedisor (ESIA) nga konsorciumi i financuar nën EBIF dhe EBRD.

Këto studime ishin një platformë e qëndrueshme për çdo hap të mëtejshëm. Projekti synon instalimin e 132 MË kapacitet të ri të rinovueshëm dhe prodhim prej rreth 470 GËh/vit, që mjafton për furnizimin e automonisë për afërsisht 70 000 familje dhe mbrojtjes nga përmbytjet në 10 000 ha tokë bujqësore për mbi 100 000 njerëz. Parashikohet krijimi i rreth 300 vendesh pune gjatë ndërtimit dhe 45 të tjera gjatë operimit – një kontribut i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik lokal. Skavica është shpallur si projekt me interes kombëtar në ligjvrim (Ligji 38/2021 dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 485/2021) që mbështet fazën teknike dhe avancimin institucional të projektit KESH ka punuar për të garantuar që projektimi dhe vlerësimet të përputhen me standardet ndërkombëtare për ESG (Environmental, Social, Governance), pjesë e iniciativës për të mbështetur qëndrueshmërinë e hidrocentralit

Dimensioni	Statusi në 2024	Komentet Pozitive
Studimet teknike	Përfunduar para vitit 2024	Siguruar bazë solide për fazat e ardhshme
Prodhimi dhe kapaciteti	Projekt prej ~132 MW, ~470 GWh/vit	Përmirëson sigurinë energjetike dhe grid-in
Përfitime socio-ekonomike	Rreth 300 punësime ndërtimi + 45 operimi	Rritje e stimulit lokal dhe ekonomisë

Dimenzioni	Statusi në 2024	Komentet Pozitive
Transparenca uniforme	Raportimi EITI mbi hidropolicinë	Modele të sjelljes transparente e publike
Rëndësi strategjike	Projekt kombëtar dhe ligjërishit i mbështetur	Politika stabile për partneritet ndërkombëtar

Në vitin 2024, projekti i Skavicës ka përparuar ndjeshëm në aspektin teknik – duke finalizuar studimet themelore dhe duke forcuar përgatitjen institucionale. Përfitimet e projektuara – nga energjia e rinovueshme te siguria e furnizimit, punësimi dhe transparenca raportuese – janë të qarta dhe të mbështetura nga dokumente dhe iniciativat zyrtare si EIB, EBRD dhe EITI. Kjo vazhdon të mbajë projektin në linjë me objektivat strategjike kombëtare dhe me parimet për energji të qëndrueshme.

Qeveria e Shqipërisë po operon nën një politikë për një rritje të shpejtë të energjisë së rinovueshme për të arritur objektivat e emetimeve neto zero. Gjatë vitit 2024, Qeveria Shqiptare ka avancuar përgatitjet për transformimin e TEC Vlorë nga një central me naftë në një njësi të re energjetike me bazë gazin natyror të lëngshëm (LNG). Projekti parashikon jo vetëm konvertimin e kapacitetit ekzistues, por edhe ndërtimin e një terminali rigazifikimi në portin e Vlorës dhe zhvillimin e infrastrukturës mbështetëse për shpërndarje LNG në tregun vendas dhe rajonal.

Ky zhvillim është pjesë e vizionit për ta shndërruar Vlorën në një qendër strategjike energjetike për Ballkanin Perëndimor. Në Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (NECP) 2024–2030, të miratuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, projekti i TEC Vlorë dhe ndërtimi i tubacionit Fier–Vlorë janë identifikuar si prioritet për diversifikimin e burimeve dhe rritjen e qëndrueshmërisë së furnizimit energjetik. Plani përfshin zhvillimin e terminalit të rigazifikimit dhe integrimin me rrjetin kombëtar të gazit përmes lidhjes me TAP, duke përforcuar rolin strategjik të Shqipërisë si nyje lidhëse në tregun rajonal të energjisë. *(Burimi: NECP Albania, 2024–2030)*

Raporti vjetor i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) për vitin 2023, i publikuar në mars 2024, konfirmon se projekti i Vlorës është pjesë e planeve zhvillimore kombëtare për integrimin e gazit natyror në portofolin energjetik të Shqipërisë. Terminali është projektuar si njësi rigazifikimi me kapacitet deri në 5 miliard metër kub gaz në vit, duke kontribuar drejtpërdrejt në forcimin e sigurisë energjetike dhe tranzicionin drejt një ekonomie me emetime të ulëta karboni. *(Burimi: Raporti Vjetor ERE, 2024)*

Gjithashtu, në dokumentacionin e përgatitur nga Sekretariati Kombëtar i EITI në Shqipëri, në kuadër të planit të punës për periudhën 2024–2025, projekti i Vlorës konsiderohet një pikë kyçe për zgjerimin e raportimit në sektorin e gazit natyror. Përfshirja e këtij projekti në transparençën sektoriale përmes EITI pritet të rrisë besueshmërinë dhe vlerën afatgjatë të investimit publik në infrastrukturën energjetike. *(Burimi: [EITI Albania, Plani i Punës 2024–2025](#))*

Në vitin 2024, Shqipëria realizoi hapa të rëndësishëm për zhvillimin e projekteve fotovoltaike, të mbështetur nga politika të qarta ligjore, ankande konkurruese dhe pilotime të suksesshme. Burimet kryesore përfshijnë Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë (2024) dhe raportet e Energy Community dhe EIBIF. Qeveria shqiptare në vitin 2024 ka nisur raundin e pestë të ankandit për projektet e reja FV dhe synon të shtojë 300 MË kapacitet të ri në rrjetin energjetik të vendit. Projektet e propozuara mund të kenë një kapacitet gjenerues të energjisë midis 10 MË dhe 100 MË, dhe se qeveria do të blinte energjinë e prodhuar në këto projekte si pjesë e një marrëveshjeje 15-vjeçare të blerjes së energjisë (PPA).

Ligji nr. 24/2023 mbi promovimin e energjive të rinovueshme miratoi objektivin kombëtar për 54.4% energji nga burime të rinovueshme deri në 2030, në përputhje me Direktivat e BE-së. Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës (NECP 2023–2030), i miratuar në fund të 2024-ës, rriti rolin e PV-së në strukturën energjetike dhe ngriti politika mbështetëse për zhvillimin e projekteve. Në Janar 2024 nisi garë konkurruese për projekte fotovoltaike me kapacitet total 300 MË, ku në korrik 8 nga 9 kompani u shpallën fituese, me një total të kontraktuar rreth 283.93 MË kapacitet të instaluar.

Kjo platformë transparente ankandimesh është vlerësuar si një model suksesi për Ballkanin Perëndimor në promovimin e energjisë së rinovueshme. Karavasta Solar Park (140 MË) u operua që nga tetori 2023 dhe më 2024 funksionon me kapacitet të plotë – është objekte më i madh solar në Ballkanin Perëndimor. Kjo plantë e rëndësishme vendos bazat për zgjerim PV dhe demonstroi aftësinë për projektim dhe menaxhim transparent dhe efikas. Projekti pilot i UNDP “Market Transformation for Solar Energy PV Acceleration” përfshiu instalimin e sistemëve PV në 10 ambiente publike në katër bashki të ndryshme (Shkodër, Klos, Durrës, Përmet), me kapacitet total rreth 1 MË deri në fund të vitit 2023; rezultati vazhdoi gjatë 2024 për përgatitje për zgjerimin e modaliteteve net-billing dhe komunitetet energjetike. Në fund të 2024-ës, kapaciteti total i energjisë solare u rrit në afro 218 MË, me rritje të konsiderueshme krahasuar me 2022 kur ishte vetëm 28 MË.

Përmbledhje – Rezultatet Pozitive të 2024

Dimensioni	Status 2024	Komente Pozitive
Ankandet PV	283.93 MW të kontraktuar	Proces transparent dhe konkurrues
Kapaciteti i operuar	140 MW Karavasta Solar Park	Funksional dhe stabil, lider rajonal
Pilotime publike PV	~1 MW në institucione publike	Si model për komunitetin dhe përfshirjen qytetare
Rritja e kapacitetit total	Nga 28 MW (2022) në ~218 MW	Rritje shumëshifrore e PV
Kuadri ligjor dhe strategjik	Ligji 24/2023 dhe NECP 2023–2030	Objektiva ambicioze dhe politika për mbështetje

Gjatë vitit 2024, Shqipëria ka bërë hapa të ndjeshëm përpara në zhvillimin e fotovoltaikës, duke kaluar nga pilotime dhe kuadër strategjik në realizimin konkret të projekteve me

kapacitet të kontraktuar dhe funksionim të plotë. Ankandet transparente, rritja e ndjeshme e kapacitetit dhe projektet lider si Karavasta e vendosin Shqipërinë drejt objektivit të 1 GË PV deri në 2030 dhe drejt diversifikimit energjetik me fokus te burimet e ripërtëritshme transparent dhe konkurrues.

II. PËRMBUSHJA E PLANIT TË PUNËS 2024–2025

RAPORTIMI EITI DHE ZHVILLIMI I TRANSPARENCËS

Ky raport paraqet një pasqyrë të plotë mbi ecurinë e zbatimit të Planit të Punës 2024 të Sekretariatit Kombëtar të AlbEITI, me fokus të veçantë tek përmbushja e detyrimeve që burojnë nga Standardi EITI 2023 dhe rekomandimet e Validimit të fundit. Gjatë kësaj periudhe, veprimtaria është orientuar drejt forcimit të transparencës dhe llogaridhënies në sektorët nxjerrës, përmirësimit të mekanizmave të raportimit dhe rritjes së besueshmërisë së të dhënave të publikuara.

Procesi ka përfshirë finalizimin dhe publikimin e raporteve të konsoliduara shumëvjeçare, nisjen e procedurave për raportet e reja, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e platformave teknologjike të transparencës, si dhe zgjerimin e fushës së raportimit për të përfshirë elementë të rinj si pronësia përfituese. Paralelisht, janë intensifikuar aktivitetet e komunikimit publik, ndërgjegjësimit dhe trajnimit të aktorëve institucionalë e privatë, duke kontribuar në rritjen e kapaciteteve vendore dhe në përmbushjen e pritshmërive të partnerëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Rezultatet e arritura gjatë vitit 2024 shënojnë një hap të rëndësishëm për rikthimin e procesit në rrjedhën e tij normale dhe për konsolidimin e rolit të AlbEITI si mekanizëm kyç i transparencës dhe qeverisjes së mirë të burimeve natyrore në Shqipëri.

Finalizimi dhe publikimi i Raportit EITI për vitet 2019, 2020 dhe 2021

Ne kuader te projektit mbështetje për raportimin e EITI: U realizuar ne vitin 2024 aktiviteti “Përzgjedhja e një firme konsulence si Administrator i Pavarur për përgatitjen e Raporteve EITI për vitin kalendarik 2019, 2020 dhe 2021 dhe për të mbështetur institucionet qeveritare dhe kompanitë nxjerrëse në procesin EITI. Rishikimi i legjislacionit aktual për raportimin sipas aktivitetit dhe në bazë të projektit në sektorin minerar dhe zhvillimin e Standardeve të Raportimit Vendor”, është i lidhur me Standardin EITI dhe gjithashtu me Veprimet Korrektuese të mbetura nga Validimi i fundit më konkretisht:

- ⊗ Kontrata dhe ndarja e licencës (Kërkesa 2.2);
- ⊗ Kontratat (Kërkesa 2.4);
- ⊗ Gjithëpërfshirja (Kërkesa 4.1);
- ⊗ Pagesat nënkombëtare (Kërkesa 4.6);
- ⊗ Ndarja (Kërkesa 4.7);
- ⊗ Besueshmëria e të dhënave (Kërkesa 4.9);
- ⊗ Shpenzimet sociale dhe mjedisore (Kërkesa 6.1);

Në ToRs të Raporteve EITI 2019-2020-2021 u parashikua në mënyrë të detajuar çdo veprim që do të ndërmerrej për të korrigjuar mangësitë e raportimit në raportet e mëparshme, për të rritur cilësinë e raportimit dhe për të qenë në përputhje me rekomandimet e lëna nga ekipi i Validimit. Termat e referencës u miratuan nga MSG dhe u shqyrtuan edhe nga Sekretariati Ndërkombëtar EITI

Pas disa vitesh vonesash për shkak të mungesës së fondeve të qëndrueshme dhe sfidave institucionale, Sekretariati finalizoi me sukses Raportin e konsoliduar EITI për tre vitet 2019, 2020 dhe 2021. Ky përbën një nga arritjet më të rëndësishme të vitit 2024 dhe shënon një pikë kthese për rikthimin në rrjedhën normale të raportimit. Raporti përfshin të dhëna fiskale, prodhuese, kontraktuale dhe institucionale, me analizë krahasuese ndërvite dhe është publikuar në mënyrë të hapur në faqen zyrtare të ALBEITI.

Nisja e procedurave për Raportin EITI 2022 dhe 2023

Gjatë vitit 2024, janë zhvilluar një sërë veprimesh për përgatitjen e dy raporteve të radhës për vitet 2022 dhe 2023:

- Hartimi i Termave të Referencës (ToR) për përzgjedhjen e Administratorit të Pavarur;
- Konsultime dhe mbledhje të dhenash për raportim me institucionet publike dhe operatorët kryesorë për sigurimin e të dhënave;
- Konsolidimi i një grupi pune teknik nga Sekretariati për mbështetjen e procesit të mbledhjes dhe verifikimit të informacionit me synimin e Realizimit të raportit nga ky I fundit.

Mirëmbajtja dhe përditësimi i Portalit të të Dhënave të Hapura dhe Kadastrës Minerare

Portali i të Dhënave të Hapura (open.albeiti.org) është mirëmbajtur rregullisht dhe është përditësuar me të dhëna të reja të nxjerra nga raportimet vjetore dhe regjistrat institucionale. Gjatë vitit 2024 ne kuader të Grantit të BB me synim mbështetjen e Sekretariatit EITI u bë e mundur : Migrimi i Portaleve Open data dhe Kadastra Minerare në serverë të rinj me siguri të rritur dhe backup automatik ditor. Rikonstruksion i ndërfaqes grafike (UI/UX) në përputhje me praktikën moderne të dizajnit ëeb. Krijimi i ndërfaqes për eksport të dhenash në formate të hapura: CSV, Excel, JSON. Integrimi i të dhënave nga institucionet për publikime të automatizuara sipas materialit fillestar. Seksion i veçantë për publikimin e raporteve vjetore, strategjive, planit të punës, buletinëve dhe të dhënave të ndara sipas vitit dhe sektorit sipas materialit fillestar .Sistem filtrimi dinamik sipas vitit, kompanisë, sektorit.

ZGJERIMI I FUSHËVE TË ZBULIMIT DHE RAPORTIMIT

Përgatitja për raportimin e Beneficial Ownership (BO)

Në përputhje me kërkesën 2.5 të Standardit EITI, Sekretariati nisi një punë zgjerimin mbi zbulimin e pronësisë përfituese:

- Janë zhvilluar diskutime me QKB për rregulloret përkatëse;

- Është punuar për realizimin e termave të referencës për përgatitjen e një raporti studimor për Pronësinë përfituese në fushën e industrisë nxjerrëse

AKTIVITETE KOMUNIKIMI, NDËRGJEGJËSIMI DHE TRAJNIME

Fushata komunikimi dhe pjesëmarrja qytetare

Në vitin 2024 u intensifikua komunikimi publik duke përzgjedhur konsulentin perkates që do të asistonte Albeitin në këto kuader i cili realizoi në vitin 2024 Spotin lidhur me Standardin EITI për ndërgjegjesim në raportim, realizoi dokumentarin për veprimtarinë EITI i cili u publikua në Facebook dhe faqen e Albeiti.

- Përgatitja e Spotit
- Fushata publicitare në TV lokale
- Fushata publicitare në TV kombëtare
- Fushata publicitare në Digital Boards
- Hapja e 3 kanaleve në Social Media
- Përgatitja e Dokumentarit
- Prodhimi dhe transmetimi i 10 meme
- Broshura EITI 100 cope
- Buletinet Dixhital 4 cope

U vijua me promovimin e studimeve dhe raporteve nëpërmjet media coverage dhe pjesëmarrjes në panele kombëtare dhe ndërkombëtare. U publikuan njoftime dhe reels informuese për rolin e Grupit Ndërinstitucional, për strukturën e ALBEITI-t dhe për transparencën në sektorët nxjerrës. Më 7 tetor 2024, Sekretariati publikoi njoftimin zyrtar për heqjen e pezullimit të Shqipërisë nga statusi i vendit anëtar në EITI.

Trajnime dhe forcim i kapaciteteve

Janë zhvilluar trajnime për stafin e institucioneve publike dhe përfaqësues të operatorëve:

- Pjesëmarrja e stafit të Sekretariatit në trajnime të organizuara nga OECD dhe GIZ dhe Qendra e Trajnimit për Energjinë;
- U realizuan trajnime me fokus transparencën fiskale dhe përdorimin e të dhënave.
- U hartua dhe u publikua për herë të parë “Plani i Integritetit Institucional 2024–2025”, si një mjet për vlerësimin e riskut dhe rritjen e besueshmërisë institucionale në raport me publikun.

Pjesëmarrje në aktivitete dhe bashkëpunime ndërkombëtare

Vizita e Misionit të Sekretariatit Ndërkombëtar EITI në Shqipëri, Qershor 2024

Sekretariati Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse dhe MSG zhvilloi një takim njëditor me ekipin e Sekretariatit Ndërkombëtar EITI Oslo të përbërë nga Z. Mark Burnett (Drejtori në detyrë për Europën) dhe Znj. Lisa Sviland (zyrtare për rajonin) për të diskutuar dhe ndarë eksperiencat e zhvillimit dhe implementimit të Standardit EITI në Shqipëri. Në këtë takim Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit EITI në Shqipëri Z. Genci Tërpo trajtoi me

implikimet për zbatimin e EITI. Përmes mësimit dhe shkëmbimit të ndërsjellë, takimi krijoi mundësi për të ndërtuar kapacitet mbi prioritetet strategjike të EITI dhe Standardin EITI 2023.



Vizita e Misionit të Bankës Botërore pranë institucionit të Sekretariatit Kombëtar Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, Tiranë, Qershor 2024

Sekretariati Kombëtar Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në datën 25 qershor 2024 priti misionin e Bankës Botërore nga Ëashington DC, të përbërë nga përfaqësuesit e saj Znj.Nina Inamahoro (udhëheqëse e ekipit dhe zyrtare operacionale) dhe Znj. Magdalena Chaëuta (specialiste në fushën e minierave). Misioni i Bankës Botërore u prit nga Drejtori i Përgjithëshëm i Albeiti Z. Genci Tërpo dhe nga stafi i institucionit i përbërë nga Znj. Emiljana Kola, Z. Lluka Gjergo dhe Znj. Majlinda Balla.

Në këtë takim u diskutua për mbarëvajtjen dhe ecurinë e projektit të Albeitit në fushën e zhvillimit të Iniciativës EITI në Shqipëri, për progresin e bërë në deri më tani në kuadrin e implementimit të aktiviteteve si dhe për avancimin në mbledhjen e të dhënave për realizimin e Raporteve EITI.

Akselerimi i veprimtarive që synojnë zbatimin e Standardit EITI të vitit 2023 në Shqipëri është misioni kryesor i institucionit të Albeiti dhe paralelisht edhe një objektiv me rëndësi i politikave të qeverisë shqiptare në tërësi. Zyrtarët e Bankës Botërore dhanë mbështetjen e tyre për të lehtësuar dhe ndihmuar institucionin dhe shtetin shqiptar në misionin si vend zbatues i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse dhe plotësimin në vazhdimësi të detyrimeve të kësaj nisme.



Takimi i Misionit të Bankës Botërore në Shqipëri me përfaqësuesit e Grupit Multifunksional të Albeiti

Sekretariati Kombëtar Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në datën 26 qershor 2024 priti misionin e Bankës Botërore nga Ëashington DC, të përbërë nga përfaqësuesit e saj Znj.Nina Inamahoro (udhëheqëse e ekipit dhe zyrtare operacionale) dhe Znj. Magdalena Chaëuta (specialiste në fushën e minierave).

Misioni i Bankës Botërore u prit nga Drejtori i Përgjithshëm i Albeiti **Z. Genci Tërpo** dhe nga stafi i institucionit i përbërë nga **Znj. Emiliana Kola, Z. Lluka Gjergo dhe Znj. Majlinda Balla** si dhe nga përfaqësuesit e Grupit Multifunksional të Albeiti ku morën pjesë **Znj. Anila Hajnaj**, (përfaqësuese e organizatave të shoqërisë civile) **Z. Robert Beshello, Z. Mynyr Sinanaj** (AKBN) dhe **Z. Bilal Koçi** (SHGJSH).

Në këtë takim u diskutua për rëndësinë e projekteve që ka ndërmarrë Albeitit në fushën e zhvillimit të Iniciativës EITI në Shqipëri, për progresin e bërë deri më tani në kuadrin e implementimit të aktiviteteve si dhe për avancimin në mbledhjen e të dhënave për realizimin e Raporteve EITI dhe të aktiviteteve të tjera.

Përfaqësuesit e MSG i mëshuan faktit që institucioni i Albeiti ka nevojë për suport të vazhdueshëm në përputhje me rëndësinë e zhvillimit të Standardit EITI në Shqipëri dhe nevojën që të mbështetet me financim edhe në vitet në vijim për të siguruar qëndrueshmëri jo vetëm në aspektin e financimit të brendëshëm por edhe në kuadrin e financimit të huaj.

Zyrtarët e Bankës Botërore dhanë mbështetjen e tyre për të ndihmuar institucionin e Albeiti dhe shtetin shqiptar në misionin si vend zbatues i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse dhe plotësimin në vazhdimësi të detyrimeve të kësaj nisme duke synuar zhvillimin sa më të shpejtë të të gjitha aktiviteteve që institucioni po ndërmerr si në aspektin e progresit sistematik të të dhënave të hapura dhe të aksesueshme për të gjithë ashtu edhe në objektivat e tjera të vendosura përmes Standardit EITI 2023.

Prioritetet strategjike të EITI-t synojnë të adresojnë sfidat globale të qeverisjes së burimeve natyrore. Ato pasqyrojnë pengesat e ndryshme që përballen vendet e pasura me burime natyrore ndërsa përshtatin zbatimin e EITI-t me prioritetet kombëtare.

Mbi këtë çështje lind detyrimi i grupeve të interesit që mbështesin Albeitin që të merren masa të vazhueshme për të përkthyer në veprime aktive zhvillimin konstant dhe të vazhdueshëm të kërkesave të Standardit EITI 2023.





Analiza e efektivitetit të zbatimit të Standardit EITI

Gjatë vitit 2024, zbatimi i Standardit EITI në Shqipëri ka shënuar një progres të ndjeshëm, duke treguar përkushtimin e institucioneve publike, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Sekretariatit të AlbEITI dhe Grupit Shumëpalësh të Interesit (MSG) për të forcuar transparencën dhe llogaridhënien në sektorët nxjerrës dhe të energjisë.

Rezultatet kryesore

- **Finalizimi i raportit të konsoliduar 2019–2021** përbën një arritje madhore, që jo vetëm riktheu Shqipërinë në rrjedhën e raportimit të rregullt, por edhe i dha fund një periudhe pezullimi. Ky rezultat tregoi se vendi ka kapacitet për të adresuar sfida komplekse dhe për të rikthyer besimin tek procesi EITI.
- **Përmirësimi i teknologjisë dhe portaleve të transparencës**, përmes migrimit në serverë më të sigurt, zhvillimit të API-ve dhe grafikëve interaktivë, ka rritur ndjeshëm aksesin publik dhe përdorimin e të dhënave.
- **Angazhimi ndërinstitucional**, i udhëhequr nga MIE dhe i mbështetur nga aktorë të tjerë përkatës, ka qenë vendimtar për sigurimin e të dhënave dhe për publikimin e raporteve të besueshme.
- **Zgjerimi i fushës së raportimit** përmes përgatitjes së termave të referencës mbi pronësinë përfituese, tranzicionin energjetik, gjininë, sigurinë në punë dhe ndikimet

socio-ekonomike tregon qartë përpjekjet për ta bërë EITI-n më gjithëpërfshirës dhe më të përafuar me zhvillimet aktuale të vendit dhe rajonit.

- **Komunikimi publik dhe ndërgjegjësimi**, përmes spoteve, dokumentarit dhe materialeve të shpërndara, ka përforcuar perceptimin pozitiv për EITI dhe për rolin e Shqipërisë si vend anëtar aktiv.

Vlerësimi i efektivitetit

Efektiviteti i zbatimit të EITI gjatë vitit 2024 vlerësohet i lartë, për disa arsye kryesore:

1. **Zgjidhja e vonesave historike** dhe rikthimi i raportimit në linjë me standardet ndërkombëtare.
2. **Rritja e cilësisë së të dhënave** dhe ndërtimi i mekanizmave teknologjikë që garantojnë akses publik të hapur dhe të kuptueshëm.
3. **Angazhimi i institucioneve shtetërore dhe MSG-së**, i cili ka qenë i plotë dhe i koordinuar, duke treguar se procesi është bërë një prioritet kombëtar.
4. **Përshtatja me prioritetet e reja**, si tranzicioni energjetik, energjia e rinovueshme dhe përfshirja gjinore, që e bëjnë EITI-n të rëndësishëm dhe aktual për zhvillimet e ardhshme të sektorëve strategjikë.

Reflektim pozitiv

Puna e bërë në vitin 2024 ka treguar se EITI në Shqipëri nuk është vetëm një proces teknik, por një mekanizëm i gjallë që bashkon institucionet, shoqërinë civile, kompanitë dhe partnerët ndërkombëtarë rreth një qëllimi të përbashkët: transparencës dhe qeverisjes së mirë të burimeve natyrore. Ky progres është një tregues i qartë se Shqipëria jo vetëm ka kapacitet për të përmbushur standardet ndërkombëtare, por edhe për t'i tejkaluar ato duke sjellë inovacione dhe duke integruar fusha të reja në raportim.

Vlerësimi buxhetor dhe burimet e financimit;

Gjatë vitit 2024, Sekretariati Kombëtar EITI Shqipëri është financuar me fonde nga Buxheti i Shtetit, dhe nga Granti TFOB998 i Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD). Financimi i brendshëm nga Buxheti i Shtetit Plani i miratuar në fillim të vitit nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka qënë 14.000.000 lekë, për periudhën Janar-Dhjetor 2024. Në muajin Dhjetor 2024, për shkak të nevojave për fonde shtesë dhe likuidimin e detyrimeve brenda afateve ligjore, për institucionin tonë janë miratuar 2.700.000 lekë shtesë në buxhet. Këto fonde janë përdorur për të përballuar shpenzimet e pagave të personelit, sigurimet shoqërore, si dhe shpenzimet operative, si më poshtë: (në lekë)

Në fund të vitit 2024, për institucionin tonë nuk rezulton asnjë detyrim i prapambetur.

Buxheti i Miratuar

Buxheti në fillim të vitit	14,000,000
Shtesa gjatë vitit	2,700,000
Pakësime gjatë vitit	-
Buxheti në fund të vitit	16,700,000
Shpenzime të realizuara	
Paga	9.438.670
Sigurime Shoqërore	1.559.100
Shpenzime Operative	5.086.559
Shpenzime për Investime	115.000
Total Shpenzime	16.119.329
Përqindja e realizimit të buxhetit	97%

Nga granti i miratuar prej 700.000 USD, i cili përfundon në 31 Korrik 2025, gjatë vitit 2024 janë disbursuar 173.380, 26 USD. Fondet e shpenzuara gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2025, paraqiten si në tabelë:(në USD)

Granti TFOB9998	700.000
Disbursuar gjatë vitit 2024	173.380,26
Shpenzime të realizuara	
Pagesa për Konsulentët	99.446,97
Shpenzime Operative	52.001
Total Shpenzime	150.448,05
Përqindja e realizimit të buxhetit	87%

Sa i takon stafit të institucionit, numri plan i punonjësve ka qënë 9, nga të cilët 5 pozicione kanë qënë të plotësuar me punonjës organike.

Vlerësimi i sfidave kryesore dhe reflektimet institucionale

1. Raportimi dhe cilësia e të dhënave

Publikimi i raportit të konsoliduar për vitet 2019–2021 në vitin 2024 ishte një arritje madhore, e cila i dha fund një periudhe vonesash dhe riktheu procesin në rrjedhën e tij normale. Ky rezultat u bë i mundur falë bashkëpunimit të ngushtë ndërinstitucional dhe angazhimit të posaçëm të **Ministrit të Financave dhe Ekonomisë**, e cila mbështeti procesin me të dhëna dhe ekspertizë të domosdoshme, si dhe përfshirjes aktive të Ministrisë. Ky kontribut dëshmoi rëndësinë që i jepet transparencës fiskale dhe partneritetit në nivel qeveritar. Sfidat që mbetet është ndërtimi i një kalendari të parashikueshëm raportimi dhe sigurimi i cilësisë më të lartë të të dhënave ndër vite.

2. Burimet financiare dhe qëndrueshmëria institucionale

Gjatë vitit 2024, falë koordinimit të mirë mes MIE-së, Ministrisë së Financave, Sekretariatit dhe partnerëve ndërkombëtarë, u siguruan fonde të nevojshme për realizimin e aktiviteteve

prioritare. Megjithatë, mbetet thelbësore të garantohet një **mekanizëm i qëndrueshëm financimi për Sekretariat**, i cili do të sigurojë stabilitet, planifikim afatgjatë dhe kapacitet për të përballuar sfida të reja. Vetëm përmes një mbështetjeje të qëndrueshme financiare AlbEITI do të mund të ruajë ritmin dhe cilësinë e arritur.

3. Integrimi i sektorëve të rinj

Përgatitja e termave të referencës për energjinë e rinovueshme, gazin dhe pronësinë përfituese është një hap shumë pozitiv që tregon përkushtimin e Shqipërisë për të zgjeruar transparencën. Sfida për vitin 2025 është që këto nisma të kthehen në rezultate konkrete, duke ruajtur angazhimin e MIE-së, Ministrisë së Financave dhe të gjithë institucioneve të tjera kyçe.

4. Angazhimi i palëve të interesuara

Viti 2024 tregoi një **angazhim të fortë të MSG-së** dhe një rritje të bashkëpunimit mes institucioneve publike, shoqërisë civile dhe kompanive. Pjesëmarrja e gjerë dhe konstruktive, sidomos në procesin e përgatitjes së raporteve dhe konsultimeve, dëshmon se ky forum është kthyer në një mekanizëm funksional dhe të besueshëm për dialog dhe transparencë.

5. Komunikimi dhe perceptimi publik

Fushatat e komunikimit dhe produktet multimediale të vitit 2024 ndihmuan ndjeshëm në rritjen e ndërgjegjësimit dhe përhapjen e informacionit për publikun. Heqja e pezullimit nga EITI dhe rikthimi i Shqipërisë si vend anëtar aktiv u pasqyrua si një sukses i përbashkët kombëtar. Sfida është që ky moment pozitiv të kthehet në një proces të qëndrueshëm komunikimi, me theks te afërsia me qytetarët dhe shoqërinë civile.

Reflektimet institucionale

- **Roli i MIE-së dhe Ministrisë së Financave** ka qenë vendimtar për suksesin e vitit 2024, sidomos në realizimin e raporteve të vonuara dhe sigurimin e një procesi të besueshëm transparence.
- **Sekretariati dhe MSG-ja** treguan kapacitet të lartë organizimi dhe koordinimi, duke hapur rrugën për integrimin e temave të reja si tranzicioni energjetik, pronësia përfituese dhe përfshirja gjinore.
- **Mbështetja financiare ndërkombëtare** ka qenë e rëndësishme, por për stabilitet afatgjatë është jetike siguri i një **financimi të qëndrueshëm kombëtar për Sekretariat**.
- **Kultura e transparencës** ka fituar terren dhe është pranuar si vlerë institucionale; tashmë sfida është që kjo të përkthehet në një praktikë të përditshme dhe në një proces më gjithëpërfshirës për publikun.

Rekomandime për punën e AlbEITI gjatë vitit 2025

1. Konsolidimi i procesit të raportimit

- Finalizimi dhe publikimi i **Raportit EITI 2022–2023**, duke respektuar afatet dhe duke shmangur vonesat që u hasën më parë.
- Nisja në kohë e procedurave për **Raportin EITI 2024**, që procesi të kthehet në një cikël vjetor të rregullt dhe të besueshëm.
- Përmirësimi i cilësisë së të dhënave përmes standardizimit të formateve të raportimit nga institucionet publike dhe kompanitë nxjerrëse.

2. Përfshirja e sektorëve të rinj dhe zgjerimi i transparencës

- Zbatimi i **modeleve të raportimit për energjinë e rinovueshme dhe gazin**, siç u përgatit gjatë vitit 2024 me ToR-të përkatëse.
- Thellimi i punës për **raportimin e pronësisë përfituese**, duke përgatitur raportin analitik dhe duke e lidhur me databazën e QKB-së.
- Integrimi i dimensionit **gjikor** në raportim, në linjë me ToR-të e vitit 2024, për të pasur tregues të matshëm mbi përfaqësimin gjikor.

3. Përmirësimi i teknologjisë dhe open data

- Zhvillimi i moduleve shtesë në **Portalit të të Dhënave të Hapura**, për të mundësuar analiza krahasuese ndër vite dhe ndër sektorë.
- Implementimi i një sistemi **dashboard interaktiv** për publikun dhe palët e interesuara (grafikë, indikatorë kyç, statistika në kohë reale).
- Sigurimi i një **mirëmbajtjeje të qëndrueshme** të serverëve dhe API-ve, me fonde të planifikuara afatgjata.

4. Komunikimi dhe ndërgjegjësimi

- Pas heqjes së pezullimit në 2024, duhet të zhvillohet një **fushatë e re informuese kombëtare** për të promovuar transparencën dhe rikthimin e Shqipërisë si vend aktiv në EITI.
- Organizimi i **takimeve rajonale** me bashkitë ku ka industri nxjerrëse për të rritur pjesëmarrjen e komuniteteve lokale.
- Prodhimi i **raporteve popullore (popular reports)** dhe infografikëve që e bëjnë informacionin më të kuptueshëm për publikun.

5. Forcimi i kapaciteteve institucionale

- Trajnime të dedikuara për institucionet publike mbi **mbledhjen dhe verifikimin e të dhënave** sipas kërkesave të EITI 2023.
- Shtrirja e **Planit të Integritetit Institucional** për të përfshirë më shumë tregues dhe për ta lidhur me matjen e performancës së stafit.
- Rritja e angazhimit të MSG-së përmes workshop-eve tematikë mbi energjinë, pronësinë përfituese dhe tranzicionin energjetik.

6. Studimet dhe konsulencat e nisura në 2024

- Përfundimi dhe publikimi i **studimit mbi pronësinë përfituese**.
- Zhvillimi i **studimit mbi tranzicionin e energjisë** dhe përgatitja e raporteve të para mbi sektorin e rinovueshëm dhe gazin.
- Përfundimi i **studimit gjinor** dhe integrimi i rezultateve në raportim.
- Zhvillimi i **analizës së ndikimeve socio-ekonomike të industrisë së naftës**, duke e lidhur me tranzicionin energjetik.
- Zbatimi i **konsulencës për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë** për industrinë nxjerrëse (2025).
- Realizimi i **studimit mbi ndikimin e investimeve të huaja** në sektorin nxjerrës dhe prezantimi i gjetjeve në MSG.

7. Angazhimi ndërkombëtar

- Pjesëmarrja aktive në **proceset ndërkombëtare të EITI** dhe përgatitja për validimin e ardhshëm.
- Shfrytëzimi i forumeve ndërkombëtare (OECD, Banka Botërore, Energy Community) për të promovuar progresin e Shqipërisë dhe për të siguruar mbështetje teknike dhe financiare.

Rekomandimet për vitin 2025 synojnë të **konsolidojnë bazën e krijuar gjatë vitit 2024**, të shndërrojnë ToR-të e nisura në produkte konkrete, të garantojnë raportim të rregullt dhe cilësor, si dhe të rrisin dukshmërinë publike dhe ndërkombëtare të Shqipërisë në EITI.

Perfundim

Viti 2024 shënoi një pikë kthese për AlBEITI: u konsolidua raportimi, u modernizuan platformat e transparencës, u zgjerua fusha e raportimit me çështje të reja si pronësia përfituese, energjia e rinovueshme, gjinia dhe siguria në punë, dhe u forcua dukshëm komunikimi publik. Këto hapa siguruan heqjen e pezullimit nga EITI dhe vendosën bazat për një fazë të re të transparencës dhe qeverisjes së mirë në industrinë nxjerrëse në Shqipëri.